



UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 02/ 2008- KRPP

Duke u bazuar në Ligjin 02/L-99 me të cilin ndryshohet Ligji nr. 2003/17 për Prokurim Publik në Kosovë të shpallur me Rregullorën nr. 2007/20 si dhe në nenin 23 të këtij Ligji. Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të Kosovës, lëshon këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është që të rregulloj mënyrën e organizimit vijimit dhe mbajtjes së testimit për vijuesit e trajnimeve të zyrtarëve të prokurimit të autoriteteve kontraktues, gjatë vitit 2008 të cilët do të pajisën me certifikata të profesionalizmit në prokurim për vitin 2009.

Neni 2 Mënyra e përcaktimit të vijuesve të trajnimit

Përfaqësuesit e Autoriteteve Kontraktuese (Sekretarët e Përhershëm të Ministrive, Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive, Drejtorët e Administratës në Komuna, Drejtorët në Kompani Publike) me shkrim do të propozojnë emrat e zyrtarëve të punësuar në Departamente të Prokurimit të autoritetit përkatës kontraktues, numrin e zyrtarëve që i është përcaktuar nga IKAP-i dhe KRPP-ja.

Neni 3 Mënyra e organizimit të testimit

Neni 23 i këtij ligji përcakton se së paku dy here në vit IKAP duhet të aranzhojë zhvillimin dhe mbajtjen e një kursi profesional të prokurimit me kohëzgjatje së paku dhjetë (10) ditë pune. Në këtë trajnim duhet të përfshihen zyrtarët e prokurimit të autoriteteve kontraktuese të cilat financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Neni 4 Pjesëmarrja në testim

Që t'i mundësohet hyrja në testim secilit zyrtarë të prokurimit i cili i ka vijuar trajnimet gjatë vitit, duhet që së paku shtatë (7) ditë t'i ketë vijuar këto trajnime. Testimi do të organizohet në javën e fundit të muajit dhjetor për çdo vit. Certifikata e profesionalizmit në prokurim do të jetë e vlefshme për vitin vijues.

Neni 5
Certifikimi

Certifikata do t'iu lëshohet vetëm atyre zyrtarëve të cilët do të tregohen të suksesshëm pas një testimi objektiv (kurdo që është e mundshme, anonim) që kanë arritur numrin e kënaqshëm të poenëve të përcaktuar me këtë udhëzim.

Neni 6

Që të pajiset me certifikatë të profesionalizmit në prokurim, zyrtari i prokurimit duhet që më së paku të arrin gjashtëdhjetë e pesë (65) pikë në testimin e organizuar nga 100 piket e mundëshme në fund të vitit .

Neni 7

Nëse në testimin e organizuar në fund të vitit vijues më tepër se 20% e pjesëmarrësve nuk tregojnë rezultate pozitive, atëhere do të organizohet një testim përmirsues në muajn janar të vitit të ardhëshëm.

Neni 8

Nëse KRPP-ja dhe IKAP-i e vlerësojnë të nevojshme organizimin e një trajnimi të përsheptuar me një grup të zyrtarëve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese në fund të vitit vijue ose në fillim të vitit të ardhëshëm, këte do ta realizojnë. Mirpo paragrafi i neni 7 nuk do të vlejë, sepse në këtë rast do t'iu mundësohet hyrja në testim përmirsues pa marrë parasysh përqindjen e rezultateve të treguara negative.

Neni 9

KRPP-ja dhe IKAP-i do të nënshkruajn një Marrveshje Bashkëpunimi me të cilën do të përcaktohen të gjitha kushtet dhe mënyra e organizimit të trajnimeve.

Prishtinë

26.08.2008

Bordi i KRPP-së

